

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Mjek Hematolog	Reparti Ushtarak nr.6023, NJMU	Tiranë	Pa afat	Po	Po	27.12.2024	06.01.2025

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Mjek Hematolog, në Klinikën e Sëmundjeve të Brendshme nr.2
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak Nr.6023, Njësia Mjekësore Ushtarake, pranë Spitalin Universitar të Traumës
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.424, datë 26.06.2024.
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 27.12.2024
8. Data e mbylljes së aplikimit: 06.01.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar së bashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- | | |
|-------------------------|---|
| a. Grada/Titulli: | Major/Civil. |
| b. Arsimi : | Të ketë përfunduar akademin ushtarake/universitetin ushtarak, të ketë përfunduar Fakultetin e Mjekësisë. Të ketë ndjekur studimet pasuniversitare master profesional. |
| c. Kualifikimi: | Të ketë ndjekur studimet pasuniversitare në specialitetin në specialitetin "Hematologji". |
| d. Trajnimi: | Trajnime në fushën e kërkuar të profesionit, konferenca mjeksore të fushës së tij. |
| e. Eksperienca në Punë: | Të ketë përvojë pune mbi 2 vite në profesion. Të ketë ekspeiençë pune në ushtrimin e profesionit. |
| f. Gjuha e huaj: | Të ketë njohuri të mira në gjuhën Angleze. |

- g. Kërkesa të tjera specifike: Të ketë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Të plotësojë kriteret për tu pajisur me certifikatë të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015. Certificate Sigurie “Konfidencial”.

13. Përshkrimi i punës: Mjeku Hematolog ndjek dhe zbaton të gjitha detyrat apo urdhrat e dhëna nga Shefii Shërbimit. Është përgjegjës për diagnostifikimin dhe menaxhimin e një game të gjerë të çrregullimeve beninje e malinje të qelizave të kuqe të gjakut, të barsha, trombociteve dhe sistemit të koagulimit tek pacientët.

Detyrat kryesore:

- Është i specializuar dhe i trajnuar në diagnostifikimin dhe trajtimin e sëmundjeve të gjakut dhe komponentëve të tij.
- Diagnostikimi dhe trajtimi i sëmundjeve të tilla si anemia, çrregullimet e gjakut si hemofilia, kanceri në gjak si leukemia, dhe infeksionet e tjera.
- Ndihmon në identifikimin e shkaqeve dhe simptomave, krijon një plan për trajtimin e problemeve të përgjithshme dhe të komplikuar.
- Parandalon, trajton dhe diagnostikon pacientët përmes këshillimit apo përshkrimit të recetave dhe performimit të ekzaminimeve përkatëse sipas rastit klinik..
- Kërkon konsultë me Shefin e Shërbimit apo specialistët e tjerë për të sëmurët në çdo orë sa herë e gjykon të domosdoshme.
- Njofton me shkrim mjekun e rojës para sesa të largohet nga puna për të gjitha problemet e veçanta në të sëmurët e tij.
- Kryen vizita plotësuese për të sëmurët e tij në çdo moment që ai e vlerëson si të domosdoshëm.
- Përgjigjet për realizimin e plotë dhe në kohë të protokolleve të mjekimit dhe të procedurave të tjera të caktuara. .

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista, zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

